

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
 ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 97/20
 Datë/Datum. 11.02.20

PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **N.P.K. " TRAFIKU URBAN " SH.A.,**
Rr. Tahir Zajmi, 10000 Prishtinë.

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr. i prokurimit	TU-19-9602-2-2-1
Nr i brendshëm	TU-19-077-221

Sa i përket tenderit për: "Mirëmbajtja e veturave zyrtare të Trafikut Urban-Ritender

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Ndërmarrja Tregtare Private „MIRI”

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Ahmet Krasniqi.

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

044/169-851

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Mirsad Gashi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

as miri@yahoo.com

(Adresa elektronike)

10.02.2020

(Data e parashurimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

N. T. P. »MIRI«
Autoservis - pjesë
ARBËRIA, Rr. A. Krasniqi
PRISHTINË

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

Ankesë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e veturave zyrtare të Trafikut Urban-Ritender" me numër të prokurimit: TU-19-9602-2-2-1 dhe numri brendshëm: TU-19-077-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues N.P.K. " TRAFIKU URBAN " SH.A.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Data e njoftimit për kontratë (në Eprokurim): 19.12.2019
- Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur
- Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:..... Kontratë publike kornizë shërbim
- Vlera e parashikuar e kontratës:..... 30,000.00 €
- Kriteri për dhënie të kontratës(N.52).....tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët - sipas peshimit të kategorive të çmimeve të përcaktuara në tabelat e përgatitura ne Excel
- Afati i fundit për dorëzimin e ofertave 30.01.2020 koha 10:00
- Data e hapjes së ofertave 30.01.2020 koha 10:00
- Data e Njoftimit për Vendimin e AK 29.01.2020
- Data e Kërkesës për rishqyrtim 01.02.2020
- Data e përgjegjëjes në Kërkesës për rishqyrtim 03.02.2020

Ankesë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e veturave zyrtare të Trafikut Urban-Ritender" me numër të prokurimit: TU-19-9602-2-2-1 dhe numri brendshëm: TU-19-077-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues N.P.K. " TRAFIKU URBAN " SH.A.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me 01.02.2020, kemi parashtruar në N.P.K. " TRAFIKU URBAN " SH.A., Kërkesë për Rishqyrtim të publikimit të Njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, por nga Autoriteti kontraktues, me 03.02.2020 na është kthyer Vendimi për Refuzimin e kësajë kërkesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues (AK) – N.P.K. “ TRAFIKU URBAN “ SH.A., në tekstin e mëtutjeshëm (Autoriteti Kontraktues), për këtë tender :

Titulli: “Mirëmbajtja e veturave zyrtare të Trafikut Urban-Ritender”,
me nr. të prokurimit: TU-19-9602-2-2-1 dhe numri i brendshëm: TU-19-077-221

sipas Tenderusit NTP „Miri” nga Prishtina, Autoriteti Kontraktues, ka bërë shkelje ligjore të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092, më tekstin e mëtejme do të i referohemi LPP-së dhe atë konkretisht :

- o Neni 1 LPP-së : (Qëllimi)
- o Neni 7: (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi),
- o Neni 56: (Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave),
- o Neni 59: (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve),
- o Neni 41.15 I RRUOPP (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve
- o Neni 60: (Kriteret për Dhënien e Kontratës),
- o Neni 69 i LPP-së (Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale)
- o Neni 71 i LPP-së (Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik).

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në vazhdim NTP „Miri”, nga Prishtina, Ju prezanton Pikat e ankesës, për shkeljet e bëra nga ana e Autoritetit Kontraktues, gjat vlerësimit të tenderit “Mirëmbajtja e veturave zyrtare të Trafikut Urban-Ritender”, duke e shpallur fitues tenderuesin Grupi i Operatorëve Ekonomik “Fitim Sha. Krasniqi B.I. & DELFIN AUTO SH.P.K, nga Prishtina, i cili është i papërgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar kërkesat e publikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen, të cilat Organi Shqyrtues i Prokurimit duhet ti merr parasysh në shpjegimin dhe arsyetimin në vijim:

- ☐ Autoritetit Kontraktues, ka shkelur nenin 1 të LPP-së (Qëllimi), sepse me rastin e qasjes në dokumentacionit të tenderuesit të shpallur fitues, të cilin na e ka dorëzuar AK, kemi konstatuar se Autoriteti Kontraktues e ka shpallur fitues tenderin e papërgjegjshëm tenderuesin Grupi i OE “Fitim Sha. Krasniqi B.I. & DELFIN AUTO SH.P.K, nga Prishtina, i cili ka dorëzuar tender të papërgjegjshëm, sepse nuk i ka plotësuar kërkesat sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, kurse oferta e tenderuesit ankues është e përgjegjshme. Me këtë rast Autoriteti kontraktues e nuk e ka arritur Qëllimin e paraparë në këtë aktivitet të prokurimit, si është paraparë në nenin 1 të LPP,

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

- o Autoritetit Kontraktues, ka shkelur nenin 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, sepse duke e shpallur tenderuesin e papërgjegjshëm Grupi i OE “Fitim Sha. Krasniqi B.I. & DELFIN AUTO SH.P.K, nga Prishtina fitues, na ka trajtuar të pabarabartë dhe na ka diskriminua me këtë veprim, sepse kompania “MIRI” ka ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmimin me të ulët i poentuar, të lexuar në hapjen e ofertave me 13.01.2020 në shumë prej 8,434,34 €.
- o Autoritetit Kontraktues, ka shkelur nenin 56 i Ligjit të Prokurimit Publik – Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2.

Ankesë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e veturave zyrtare të Trafikut Urban-Ritender” me numër të prokurimit: TU-19-9602-2-2-1 dhe numri brendshëm: TU-19-077-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues N.P.K. “ TRAFIKU URBAN “ SH.A.

të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2 së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji;

Duke u bazuar në këtë nen të cekur më lartë ne mendojmë se Autoritetit Kontraktues ka dështuar në përzgjedhjen e fituesit, në bazë të kërkesave dhe kriterit, që vet i ka përcaktuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), Faqe 17

Tenderit (FDI), Fajë 7

Kriteret e Dhënies	30.1	Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët me poentim.		
		Sipas peshimit në %, të grupit të pozicioneve të përcaktuara në Pjesën C të formulari për dorëzimin e tenderit, Pjesa II. Lista e çmimeve-oferta financiare.		
		REKAPITULLIMI:	Çmimi	Pesha e Çmimit
		1 Nën totali I tabelës 1	-	60 %
		2 Nën totali I tabelës 2	-	25 %
		3 Nën totali I tabelës 3	-	15 %
		TOTAL	-	100 %
		në hapje do të lexohet çmimi me poentim (peshim)		

Autoriteti Kontraktues nuk e ka përfillë këtë kërkesë të vendosur në DT, duke e lexuar Ofertën e tenderuesit të shpallur fitues Grupi i OE "Fitim Sha. Krasniqi B.I. & DELFIN AUTO SH.P.K, nga Prishtina pa poentim (peshim), shih B12-Proces verbal i hapjes së Tenderëve i datës 13.01.2020.

- ☐ Autoritetit Kontraktues, po ashtu e ka shkelur nenin 56 i LPP-së, sepse e ka shpallur fitues tenderuesin i cili është administrativisht i papërgjegjshëm, sepse Nuk e ka plotësuar dhe nënshkruar si duhet Formularin e paraqitjes së tenderit, Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE, andaj është dashtë që Tenderi i Grupit të OE "Fitim Sha. Krasniqi B.I. & DELFIN AUTO SH.P.K, nga Prishtina të refuzohet dhe të shpallet i papërgjegjshëm sepse tenderuesi i shpallur fitues ka ofruar çmimin me 0.00 € në ofertën financiare - Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE, te

Pjeset Mekanike tabela (2)-25% e pikëve, pozicionet 7, 23, 25, 26, 30, 42, 45 dhe

Pjeset Mekanike : Tabela (3)- 15% e pikëve, te pozicioni 35,

që është në kundërshtim me Nenin 41.15 (Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik), citojmë:

41.1 Ne rast se OE, ofron çmimin me 0.00 Euro për një artikull të veçantë mund të ketë arsye të ndryshme dhe për këtë arsye nevojitet që të dërgohet

Ankesë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e veturave zyrtare të Trafikut Urban-Ritender" me numër të prokurimit: TU-19-9602-2-2-1 dhe numri brendshëm: TU-19-077-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues N.P.K. " TRAFIKU URBAN " SH.A.

një pyetje sqaruese tek Operatori Ekonomik duke kërkuar shpjegim për pozicionin 0.00 Euro.

1. Nëse Operatori Ekonomik pranon se ai artikull i veçantë nuk është i përfshirë në tender, tenderi duhet të refuzohet.
2. Nëse Operatori Ekonomik thotë se ky artikull është ofruar falas, tenderi duhet të refuzohet pasi që dhuratat nuk janë të pranueshme.

Lidhur me rastin e paraqitur në këtë tender, kemi interpretim Ligjor edhe nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të INFORMACIONE / PYETJE TË SHPESHTA, lidhur me këto raste (pyetja dhe përgjigjja 39) si vijon:

29. Cila është procedura që duhet ndjekur në rast se Operatori Ekonomik vendos çmimin "0.00" euro në një nga artikujt/pozicionet (elementet përbërëse të tenderit)? (Referoju RRUOPP)

KRPP Një procedurë e tillë nuk është e rregulluar me dispozita të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe as me legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, megjithatë autoritetet kontraktuese duhet të veprojnë si në vijim:

Nëse Operatori Ekonomik nuk plotëson një nga pozicionet në Listën e Përshkrimit të Çmimeve, tenderi duhet të refuzohet, pasi që tenderi gjithmonë duhet të jetë në përputhje me qëllimin e plotë të kontratës.

Nëse Operatori Ekonomik ofron çmimin "0.00" në një nga pozicionet, tenderi duhet të refuzohet ngase në "Përshkrimin e çmimeve" kërkohej të vendoset çmimi në vlerë të caktuar për secilin artikull/pozicion të kërkuar në specifikimin teknik.

Nëse Operatori Ekonomik plotëson në një nga pozicionet si: "gratis", tenderi duhet të refuzohet pasi që dhuratat nuk janë të pranueshme.

Nga kjo që u tha shihet se Autoriteti Kontraktues pa të drejtë e ka shpallur fitues, tenderuesin e përgjegjshëm, i cili nuk i plotëson kërkesat e Nenit 56 të LPP, (*Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave*), siç është kërkuara në fletën e të dhënave të tenderit në dosjen e tenderit. Prandaj nga arsyet e cekura më lartë, oferta e tij është dashtë të refuzohet dhe nuk kalon në vlerësimin e më tutjeshëm, sepse në disa pozicione që automjetet i ka pjesët për mirëmbajtje fituesi ka vendos çmim 0.00 €, (Pjesët Mekanike tabela (2)-25% e pikëve të art/ 25. Rripi i kompresorit klimës, art. 26. Rrypi i servo timonit-set), etj.

- o Tenderusi, NTP „Miri”, ka konstatuar se Autoritetit Kontraktues ka shkelur nenin 59 i LPP-së -Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, dhe neni 41 i Rregullave dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik në Kosovë, ku Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm, vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, të cilat tenderi i Grupit të Operatoreve Ekonomik të shpallur fitues, nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat.

Grupit të OE "Fitim Sha. Krasniqi B.I. & DELFIN AUTO SH.P.K, nga Prishtina, nuk ka dorëzuar tender të përgjegjshëm pasi nuk ka dorëzuar dëshmi si është kërkuar në faqen 15 të

Dosjes së tenderit - SEKSIONI II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) Pika 9.1 & 9.2 (Kapaciteti teknik dhe profesional):

9.1. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

f. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë së paku dy (2) kontrata për servisimin e automjeteve, të realizuar në tri vjetët e shkuara para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë.

Kapacitetet profesionale te stafit

1. Automekanikë - minimum një (1).

2. Autoelektricitist - minimum një (1).

Dokumentet dëshmuese për mundësitë teknike dhe/ose profesionale

f. Lista e kontratave, projekteve me të cilën saktësohen shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Listës duhet t'i bashkëngjiten dëshmi kopjen e certifikatës (certifikatave) ose referencës, të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat dhe projektet e cekura në listë, (kopje).

Dokumentet dëshmuese për mundësitë profesionale

1. Diplomë ose certifikatë kualifikimi, kontratë valide e punës, (kopje).

2. Diplomë ose certifikatë kualifikimi, kontratë valide e punës, (kopje).

Në dokumentacionin e qe na është dorëzuar, pas qasjes në dokumentacionin e tenderit fitues, kemi konstatuar se tenderuesi fitues nuk ka dorëzuar fare Listën e kontratave, dy referencat e vetme të dorëzuara nga anëtar i grupit të OE "Delfin Auto" janë më tepër për furnizim.

Te kapacitetet profesionale te stafit- a. Automekanik, tenderuesi i shpallur fitues, nuk ka ofruar-bashkëngjitur mjaftueshëm si është kërkuar, për këtë pozitë nuk kanë bashkëngjitur diplomën apo certifikatë përkatëse, por për Fitim Krasniqin është bashkëngjitur diplomë të metalpunuesit (Makineri –Tornitor). Andaj edhe në këtë pikë Autoritetit Kontraktues ka shkëlur nenin 59 i LPP-së dhe Nenin 41.15, sepse tenderi i Grupit të OE "Fitim Sha. Krasniqi B.I. & DELFIN AUTO SH.P.K, nga Prishtina, nuk i ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, prandaj tenderi i tij është i papërgjegjshëm.

- Është shkëlur neni 60 i LPP-së- Kriteret për Dhënien e Kontratës, përkatësisht Dosja e tenderit Seksioni II. Fleta e të Dhenave të Tenderit (FDT), Kriteret e Dhënies pika 31.1

Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik-që ka dorëzuar : Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët me poentim;

Sipas peshimit në %, të grupit të pozicioneve të përcaktuara në Pjesën C të formulari për dorëzimin e tenderit, Pjesa II. Lista e çmimeve-oferta financiare.

Oferta e tenderuesit të shpallur fitues, Grupit të OE "Fitim Sha. Krasniqi B.I. & DELFIN AUTO SH.P.K, nga Prishtina, nuk është poentuar-peshuar fare dhe është lexuar në hapje

Ankesë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e veturave zyrtare të Trafikut Urban-Ritender" me numër të prokurimit: TU-19-9602-2-2-1 dhe numri brendshëm: TU-19-077-221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues N.P.K. " TRAFIKU URBAN " SH.A.

pa poentim, qka është vepruar në kundërshtim me kriterin e për caktuar nga ana e AK, kjo qështje është e rregulluar me nenin 56.15 të RRUOPP, citojmë:

56.15 Kurdo qe Autoriteti kontraktues nuk dine sasitë indikative, *kontratat me çmime për njësi*, AK duhet te përcaktoj peshën ne baze të rëndësisë se secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Ne këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje te veturave, mirëmbajtje te gjeneratorëve etj. Ne këto raste ne hapje publike te ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim te vlerësimit te ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi. Shuma e sigurimit te ekzekutimit te kontratës ne këto raste duhet te përcaktohet si shume fikse ndërsa për qëllime te raportimit ne KRPP shënohet vlera e parashikuar e kontratës. Kontratat me çmime për njësi mund te udhëhiqen për te gjitha llojet e kontratave, kontratë për furnizime, shërbime dhe pune.

- o Është shkelur neni 71 i LPP-së (*Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik*) - si është kërkuar në DT, te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik pika 11.1
- a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës;
- b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;
- c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit; dhe
- d. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT..

Në dokumentacionin e qe na është dorëzuar, pas qasjes në dokumentacionin e tenderit fitues, kemi konstatuar se tenderuesi fitues ka shkelur nenin 71 i LPP-së sepse nuk ka dorëzuar fare:

- b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;

Edhe në përgjigjeje në kërkesën për rishqyrtim, vet e kanë pohuar se mungon kjo deklaratë, pasi që i kanë bashkangjitur vetëm deklaratën nën a) dhe nën c) kurse deklarata nën b) fare nuk është dorëzuar nga tenderuesi i shpallur fitues.

Andaj, pas këtyre argumenteve të prezantuara më lartë, për parregullsitë dhe shkeljet e cekura nëpërmjet kësaj ankese, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, ta aprovoj ankesën tonë, të marr vendim mbi anulimin e njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e veturave zyrtare të Trafikut Urban-Ritender", me nr. të prokurimit: TU-19-9602-2-2-1 dhe numri brendshëm: TU-19-077-221 dhe lënda të kthehet në Ri vlerësim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale janë në angazhimin e personelit për përgatitjen e dokumentacionit dhe dosjes së tenderit dhe ekspertit për përgatitjen e Kërkesë për Rishqyrtim dhe Ankesës për OSHP.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"*
- b) *një kopje të publikimit për "NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK".*
- c) *Procesverbalin e hapjes*
- d) *Kopjen e Kërkesës për rishqyrtim*
- e) *Kopjen e përgjegjëjes në Kërkesës për rishqyrtim*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*